



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 12/19) dhe nenit 40 paragrafi 1 nga Rregullorja për punë të Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit të dorëzuar nga parashtruesi i njohur në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, morri këtë

### VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-4932/1 me datë 22.10.2019 formuar pas denoncimit nga parashtruesi ..... të dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën me numër 12-4932/1 me datë 22.10.2019, përshkak se akuzat në denoncim nuk janë vërtetuar.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet vendimi i KSHPK me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditësh nga dita e vendimmarrjes.

### Sqarim

Lënda me numër 12-4932/1 me datë 22.10.2019 e formuar mbi bazë të denoncimit së marrur nga parashtruesi .....

Në denoncim tregohet për akuza për dyshime për parregullësi lidhur me procedurën për zgjedhje të përmbaruesit nëpërmjet shpalljes publike nr. 143/2019 në Agjensionin për supervisor të sigurimit dhe me marrjen e Vendimit për zgjedhjen e tre përmbaruesve nëpërmjet shpalljes publike nr. 143/2019 e marrur me 01.10.2019, në kundërshtim e rregullat ligjore për zgjedhje të kandidatëve më mirë të ranguar në procedurën për punësim pas kryerjes transparente, fer dhe procedurë konkurente për selektim të kandidatëve. Në denoncim theksohet se parashtruesi pas realizimit të të gjitha fazave të selektimit ka qenë ranguar i pari në rang-listën përfundimtare për vendin e punës Këshilltarë për çështje drejtpërdrejtë të lidhura me Këshillin e ekspertëve, fitoi 81,01 pikë, dhe përskaj kësaj është marrë Vendim me të cilën për përmbarues në vendin e punës ka qenë zgjedhur person tjetër. Në denoncim theksohet se rang-lista përfundimtare nga të gjitha fazat e selektimit të kandidatëve për zyrtarë administrativ pas shpalljes numër 143/2019 ka qenë larguar nga Agjensioni për administratë në ditën e publikimit të vendimit për zgjedhje, dhe është mëshetur për kohën derisa zgjatë afati për ankesë, parashtruesi udhëzon në dyshime për pjesëmarrje në Agjensionin për administratë në veprimin e parrugllësive dhe joligjore në realizimin e zgjedhjes së përmbaruesit në vendin e punës për të cilën ka konkuruar parashtruesi i denoncimit. Me datë 02.10.2019 nga ana e parashtruesit është kërkuar rang-lista që t'i dorëzohet, mirëpo kërkesa e tij nuk është përgjigjur.

Me qëllim të kontrollimi të akuzave në denoncim dhe caktimit të gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK dërgoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-500/1 me datë 24.01.2020 me të cilën kërkon nga Agjensioni për supervizor të sigurimeve në RMV të dorëzon informacione të plota me sqarime për shkaqet e mospublikimit të rang-listëtës përfundimtare nga të gjitha fazat e selektimit të kandidatëve për zyrtarë administrativ nëpërmjet shpallje publike nr. 143/2019 në ditën e publikimit të Vendimit për zgjedhje të tre përmbaruesve nëpërmjet shpallje publike nr. 143/2019 me numër 02-671/1 me datë 01.10.2019, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen për zgjedhjen e çdonjërit nga kandidatët të theksuar në Vendimin për zgjedhje të tre përmbaruesve nëpërmjet shpalljes publike nr. 143/2019 me numër 02-671/1 me datë 01.10.2019, duke theksuar pikët e fituara të çdo njërit nga kandidatët e zgjedhur nga të gjitha fazat e selektimit me shtojcë Rang-lista përfundimtare e kandidatëve (me theksimin e emrave dhe mbiemrave të kandidatëve) për të gjitha vendet e punës të theksuar në shpalljen numër 143/2019.

Agjensioni për supervizor të sigurimeve në RMV në afatn kohor të përcaktuar me ligj dorëzoi përgjigje për kërkesën e KSHPK.

Pas rishikimi të përgjigjes së dorëzuar, me qëllim të mbledhjes për informacioneve plotësuese KSHPK dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-500/3 me datë 19.02.2020 deri tek Agjensioni për administratë me të cilën kërkon që Agjensioni për administratë të RMV në kuadër të kompetencave të veta ligjore të dorëzon informacione të plota me sqarime në lidhje me procedurën që është udhëhequr në Agjension pas parashtrimit të ankesës nga kandidati ..... kundër Vendimit për zgjedhje të 3 (tre) përmbaruesve nëpërmjet shpalljes publike nr. 143/2019, marrur me datë 01.10.2019 nga Kryetari i Këshillit të ekspertëve të Agjensionit për supervizor të sigurimeve, me dorëzimin e Vendimit të marrur nga ana e Agjensionit për administratë në këtë procedurë. Në afatin e caktuar ligjor është dorëzuar përgjigja e kërkuar nga Agjensioni.

Pas rishikimit të akuzave në denoncim dhe të dhënave të mbledhura nga institucione tjera kompetente, KSHPK vërtetoi këtë:

Me datë 27.08.2019 është publikuar shpallje publike me numër 143/2019 për punësim të tre zyrtarëve administrativ në Agjensionin për supervizor të sigurimeve. Parë nga shpallja publike për vendin e punës 1 – ACO 01 01 B01 012 – Këshilltarë për çështje të drejtpërdrejta me Këshillin e ekspertëve në Drejtorinë për çështje të drejtpërdrejta lidhur me Këshillin e ekspertëve, është paraprë punësimi i 1 (një) përmbaruesi.

Me datë 02.09.2019 me Vendim numër 10-1417/3 është formuar Komision për selektim për punësim nëpërmjet shpalljes publike, e cila ka realizuar selektim administrativ të kandidatëve me çka është përgaditur Procesverbal nga bërja e selektimit administrativ me numër 10-1417/4 me datë 16.09.2019. Pas mbarimit të selektimit janë realizuar dy faza nga procedura për selektim për punësim, provim për zyrtarë administrativ dhe kontrollim të besueshmërisë të fakteve dhe intervju për çka janë përgaditur Procesverbale. Komisioni për selektim ka përgaditur rang-listë të kandidatëve të cilët me sukses i kaluan fazat e procedurës për zgjedhje, pas të cilës është përgaditur dhe Propozim për punësim të kandidatëve nëpërmjet shpalljes publike numër 143/2019. Në bazë të Propozimit për punësim nëpërmjet shpalljes publike numër 143/2019 me numër 1417/7 me datë 01.10.2019 Kryetari i Këshillit të ekspertëve të Agjensionit për supervizor të sigurimeve morri Vendim për zgjedhje të tre përmbaruesve me çka për përmbarues në vendin e punës është zgjedhur kandidati ..... I pakënaqur me vendimin e marrur parashtruesi i denoncimit dërgoi ankesë kundër Vendimit

tē pērmendur duke theksuar se me vendimmarrjen e vendimit ēshtē lēnduar (dēmtuar) e drejta e garantuar me kushtetē pēr qasje deri nē qđo vend tē punēs me kushte tē njējta dhe se kufizimi i tē drejtēs qđon kah diskriminimi. Pas parashtrimit tē ankesēs Komisioni i Agjensionit pēr administratē pēr vendimmarrje pēr ankesa dhe kundērshtime tē zyrtarēve administrativ nē shkallē tē dytē, veptoi dhe morri Vendim me numēr 09-526/6 me datē 16.10.2019 me tē cilēn ankesa e parashtruesit ..... deklaruar kundēr Vendimit pēr zgjedhje tē tre pērmbaaruesve nēpērmjet shpalljes publike numēr 143/2019 numēr 02-671/1 me datē 01.10.2019 marrur nga Kryetari i kēshillit tē ekspertēve tē Agjensionit pēr supervizor tē sigurimeve ēshtē rrefuzuar si e pa bazē me sqarim se kandidati i zgjedhur ēshtē ranguar mē mirē me pērkatēsi tē nacionalitet Shqiptarē (re) e cila pērkatēsi nationale kērkohej nē shpalljen publike konkrete, dhe nē pērputhje me Planin vjetor tē institucionit. Gjithashtu Komisioni konstatoi se procedura pēr selektim pēr punēsim ēshtē udhēhequr nē pērputhje me rregullativat positive ligjore. Nē lidhje me akuzat e ankesēs pēr shkelje tē tē drejtēs tē garantuar me kushtetutē pēr qasje deri nē qđo vend tē punēs me kushte tē njējta, Komisioni e udhēzoi parashtruesin e ankesēs se nē pērputhje me Ligjin pēr parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi tē drejtohet deri tek Komisioni pēr parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Nga vēzhgimi i dokumentacionit tē dorēzuar nē formē tē letrēs nga denoncimi elektronike pēr punēsim tē zyrtarēve administrativ tē kandidatit tē zgjedhur ..... e cila mes tē tjerash ēshtē vērtetuar se ky person nē rubrikēn "Pērkatēsia nationale" ēshtē shprehur si shqiptarē (re).

Nē bazē tē tē theksuarēs mē larēt gjendja faktike e caktuar, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit konstaton se vepruan organe tjera kompetente (Agjensionit pēr supervizor tē sigurimeve nē RMV dhe Agjensionit pēr administratē) tē cilēt nē kuadēr tē kompetencave tē veta ndērmorrēn procese vepruese nē pērputhje me ligjin dhe morrēn vendim nē bazē tē ligjit, pērshkak se KSHPK pērfundoi se akuzat nuk janē vērtetuar dhe elemente pēr veprime tē mētutjeshme nē rastin e lēndēs nuk ka. Lēnda tē mbyllet dhe tē arkivohet. Duke pasē parasyshē tē theksuarēn mē lartē, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vendosi nē dispozitē tē kētij vendimi.

Punoi: m-r I.P.  
Miratoi: S.P.D., anētar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETĊOROR PĊR  
PARANDALIM TĊ  
KORRUPSIONIT  
Kryetarē: Biljana Ivanovska**

